

Në bazë të nenit 29 paragrafi 2 nga Ligji për informata të klasifikuara (*) („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.275/49), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në mbledhjen e mbajtur më datë 5 korrik 2022, miratoi

URDHËRESË PËR SIGURI TË PERSONAVE - SHFRYTËZUES TË INFORMATAVE TË KLASIFIKUARA (*)

Neni 1

Me këtë urdhëresë rregullohen masat dhe aktivitetet për siguri të personave - shfrytëzues të informatave të klasifikuara

Neni 2

Lëshimi i certifikatës së sigurisë për personat shfrytëzues të informatave të klasifikuara fillon me parashtrimin e kërkesës për lëshim të certifikatës së sigurisë (në tekstin e mëtutjeshëm: kërkesa).

Në kërkesë jepet sqarim për nevojën e përdorimit të informatave të klasifikuara në pajtim me principin “Nevojitet të dijë”. Kërkesës i shtohet pyetësi i sigurisë i plotësuar si dhe dokumentet përkatëse për përmbushjen e kushteve të rregulluara me ligj, në pajtim me shkallën e certifikatës së sigurisë, edhe atë:

- për identitetin, moshën, shtetësinë e personit për të cilin kërkohet certifikata, (kopje nga letërnjoftimi dhe dokumenti për udhëtim (nëse ka);
- vërtetim për aftësi të punës nga gjykata kompetente;
- vërtetim nga organi kompetent se personi nuk ka ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- vërtetim (jo më i vjetër se gjashtë muaj) se personi nuk është i dënuar;
- vërtetim se personi është trajnuar për manipulim me informata të klasifikuara.

Neni 3

Identiteti, mosha, shtetësia, aftësia për punë, dokument se nuk është i dënuar, vërtetim se personit nuk i është shqiptuar sanksioni - ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe trajnimi për manipulim me informata të klasifikuara për personin për të cilin kërkohet certifikata e sigurisë, vërtetohet nga ana e Drejtorisë për siguri të informatave të klasifikuara, në bazë të dokumenteve të dorëzuar me kërkesën.

- Ekzistimi i rrezikut të sigurisë për personin për të cilin kërkohet lëshimi i certifikatës së sigurisë, vërtetohet nga ana e Drejtorisë në bazë të kontrollit të sigurisë i cili zbatohet nga ana e organeve kompetente me çka vërtetohet ekzistimi i pengesave të sigurisë, për qasje dhe manipulim me informata të klasifikuara, edhe atë:
 - vetëm për personin që kërkon certifikatë të sigurisë, kryhet kontrolli për shkallën e parë;
- për personin që kërkon certifikatë të sigurisë dhe për personat për të cilët janë dhënë të dhëna në pyetësor, kryhet kontrolli i sigurisë për shkallën e dytë;

- për personin që kërkon certifikatë të sigurisë dhe për personat për të cilët janë dhënë të dhëna në pyetësor të sigurisë, kryhet kontrolli i sigurisë për shkallën e tretë.

Neni 4

Vlerësimi për ekzistimin e pengesave të sigurisë për personin për të cilin kërkohet lëshimi i certifikatës së sigurisë, vërtetohet përmes fakteve, të dhënave nga organet shtetërore kompetente dhe institucioneve ose nga të dhënat ose informatat të cilat i kanë organet kompetente për kryerjen e kontrolleve të sigurisë, varësisht nga shkalla e kontrollit të sigurisë:

1. ka kryer ose ka tentuar të kryej, është shoqëruar me persona të tjerë, ka ndihmuar ose ka nxitë dikë tjetër të kryej (ose që ka tentuar të kryej) çfarëdo veprimi të lidhur me spiunim, terrorizëm, ekstremizëm të dhunshëm, të gjitha format të aktiviteteve serioze kriminele të drejtuar kundër shtetit, njerëzisë dhe të drejtës ndërkombëtare, shkatërrimin e interesave vitale ekonomike dhe sigurisë financiare në shtet, si dhe aktivitete të tjera të lidhura me kërcënime të sigurisë për sigurinë nacionale të shtetit;
2. ka qenë ose është bashkëpunëtor i njerëzve të cilët kanë kryer veprime nga pika 1 e këtij neni, ose është bashkëpunëtor me njerëz për të cilët ekziston dyshimi se kanë kontakte të rëndësishme nga aspekti i sigurisë nacionale me përfaqësues të organizatave ose shteteve të huaja, të cilët mundet që ta rrezikojnë sigurinë nacionale të shtetit ose bashkësive ndërkombëtare dhe organizatave në të cilat merr pjesë shteti, përveç nëse ato kontakte janë në korniza të detyrës zyrtare;
3. ka qenë ose është anëtar i ndonjë grupi ose organizate e cila ndërmerr ose ka ndërmarr mjete antishtetërore të dhunshme, subversive ose mjete tjera jologjore;
4. ka qenë ose është mbështetës i ndonjë grupi ose organizate të përshkruar në pikën 3 të këtij neni, ose ka qenë ose është ngushtë i lidhur me anëtarë të grupeve të atilla ose organizatave;
5. ka fshehur, gabimisht ka paraqitur ose falsifikuar informata me domethënie, sidomos me karakter të sigurisë, ose me qëllim ka gënjyer gjatë plotësimit të pyetësorit ose gjatë kohës së intervistës së sigurisë;
6. është i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale, e cila mund të paraqet pengesë të sigurisë për qasje dhe manipulim me informata të klasifikuara;
7. në periudhën kohore kur është vërtetuar si relevante shkalla e kontrollit të sigurisë, personi i cili ka qenë i dënuar për vepër penale mund të paraqet pengesë të sigurisë për qasje ose për manipulim me informata të klasifikuara;
8. ka probleme financiare ose në mënyrë jo të qartë është pasuruar;
9. ka histori se është i varur nga alkooli, përdor lëndë narkotike ose substanca psikoterapie dhe/ ose keqpërdorim të barnave;
10. ka qenë ose është i kyçur në aktivitete të cilat mund të sjellin deri te rreziku nga dobësia ndaj kërcënimeve ose shtypjes, duke përfshirë edhe çfarëdo forme të shqetësimit seksual;
11. demonstroi jo ndershmëri, jo lojalitet, pabesi, jo diskreditim ose lojalitet ndaj një shteti tjetër;
12. në mënyrë serioze ose vazhdimisht i ka thyer kriteret, masat dhe aktivitetet për mbrojtje të informatave të klasifikuara ose ka tentuar ose ka arritur ose ka qenë i përfshirë në aktivitete të paautorizuara në lidhje me sistemet komunikuese-informatike;

13. ka vuajtur ose vuan nga çfarëdo sëmundje ose gjendje mentale ose emocionale, e cila gjendje mund të ndikoj me të meta të mëdha në vlerësimin e tij të drejtë ose besueshmërinë e tij, ose ajo gjendje mund ta bëj, paqëllim, personin, rrezik potencial të sigurisë, e cila gjendje vërtetohet me dokumente mjekësore;
14. mundet të jetë i dobët ndaj shtypjeve nga ana e farefisit ose bashkëpunëtorët e ngushtë të cilët mundet të jenë të dobët ndaj shërbimeve të huaja të inteligjencës, grupeve terroristë dhe organizatave subversive ose nga individë të cilët interesat e të cilëve mundet ti rrezikojnë intereset e sigurisë së shtetit.

Neni 5

Para se të lëshohet certifikata e sigurisë për qasje deri te informatat e klasifikuara me shkallën SEKRET, kontrolli i sigurisë i cili zbatohet i përfshin më së paku pesë vitet e fundit, gjegjësisht prej vitit kur personi - kërkues i certifikatës së sigurisë, ka mbushur 18 vite deri në momentin e kontrollit, nëse kjo periudhë kohore është më e shkurt se 5 vite dhe i përfshin aktivitetet e radhës:

1. kontrolli i identitetit, data dhe vendi i lindjes, mosha dhe shtetësia (e tashme dhe e mëparshme) e personit;
2. kontroll në evidencën kriminale (penale, ndëshkuese dhe kundërvajtës) dhe evidenca të tjera të organeve kompetente me qëllim kontroll e të dhënave për ekzistimin e pengesave të sigurisë;
3. kontrolli i të dhënave për shkollimin duke filluar nga shkolla e mesme;
4. kontrolli i të dhënave për punësim me qëllim që të bëhet vlerësimi i efikasitetit dhe lojalitetit të personit si i punësuar;
5. kontrolli i të dhënave për ekzistimin e rrezikut të sigurisë nga aktivitetet dhe anëtarësimi në organizata dhe grupe të cilat kanë për qëllim prishjen e sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
6. nëse nga kontrolli i parë i të dhënave, janë zbuluar informata potenciale negative, për personin që kërkon certifikatë të sigurisë ose për personat që janë të shënuar në pyetësor të cilët mundet të ndikojnë, gjatë vërtetimit të lojalitetit, besueshmërisë dhe rrezikut të sigurisë te personi që kërkon certifikatë të sigurisë, atëherë personi që ka bërë kërkesë për certifikatë të sigurisë, thirret në intervistë;
7. kontrolli i të dhënave për shërbimin policor dhe ushtarak të personit që kërkon certifikatë të sigurisë (ku mund të zbatohet);
8. kontrolli i të dhënave për qëndrim dhe aktivitete në shtete tjera me qëllim të vërtetohet nëse personi që kërkon certifikatë të sigurisë ka pasur interes dhe kontakte me njerëz të shteteve të huaja, të cilët janë të rëndësishme nga aspekti i sigurisë nacionale dhe të cilët kontakte do të paraqitnin rrezik dhe se personi nuk do të kishte mund të përballlet me shtypjet, nëse do ti bëheshin;
9. kontrolli i të dhënave për gjendjen shëndetësore;
10. aktivitetet me lëndët narkotike dhe /ose alkool me qëllim të vërtetohet nëse personi që kërkon certifikatë të sigurisë është i varur nga alkooli ose droga ose të tjera substanca psikoterapie, ka qenë i sëmur ose është i sëmur nga sëmundje ose gjendje mentale të cilat mundet të paraqesin rrezik të sigurisë sa i përket aftësisë së tij për t'i vlerësuar/gjykuar gjërat drejt;

11. kontrolli i të dhënave për certifikatat e sigurisë që me herët i ka pasur me qëllim që të vërtetohet si ai është sjell gjatë manipulimit me informata të klasifikuara;
12. kontrolli i të dhënave nga rrjetet sociale me qëllim që të marrin edhe më shumë të dhëna plotësuese të cilat do të ndikonin gjatë vërtetimit të rrezikut të sigurisë të personi - kërkues i certifikatës së sigurisë.

Neni 6

Para se të lëshohet certifikata e parë e sigurisë për qasje në informata të klasifikuara me shkallën TEPËR SEKRET, kontrolli i sigurisë i cili zbatohet i përfshin më së paku dhjetë vitet e fundit, gjegjësisht nga mosha 18 vjeçare deri në momentin e kontrollit nëse kjo periudhë kohore është më e shkurt se dhjetë vite dhe përkrah aktiviteteve të nenit 5 nga kjo urdhëresë i përfshin dhe aktivitetet e radhës:

1. kontrolli i identitetit, datës dhe vendit të lindjes, mosha dhe shtetësia (e tashme dhe e mëhershme) e personave të dhënat e të cilëve janë të shënuara në pyetësor dhe
2. kontrolli i të dhënave për gjendjen personale financiare dhe pronësore bëhet me qëllim që të vlerësohet/parashihet çdo mundësi nëse personi mund të tregohet i dobët nëse i bëhet shtypje nga brenda ose nga të huajt për arsye të problemeve serioze financiare, ose që të zbulohet ndonjë pasurim i papritur.

Neni 7

Para se të lëshohet certifikata e parë e sigurisë për qasje në informata të klasifikuara me shkallën SEKRET SHTETËROR, kontrolli i sigurisë i cili zbatohet i përfshin më së paku dhjetë vitet e fundit, gjegjësisht nga mosha 18 vjeçare deri në momentin e kontrollit nëse kjo periudhë është më e shkurt se dhjetë vite dhe përkrah aktiviteteve të nenit 5 dhe 6 nga kjo urdhëresë përmban edhe zbatimin e intervistës me qëllim vërtetimin e aftësisë së personit për manipulim me informata të klasifikuara.

Neni 8

Nëse gjatë kontrolli të sigurisë fitohen të dhëna të cilat janë pjesë e kontrollit për shkallë më të lartë, të njëjtat do të merren parasysh gjatë vlerësimit të pengesave të sigurisë për lëshimin e certifikatës së sigurisë për qasje deri te informatat e klasifikuara për shkallë më të ulët.

Neni 9

Në bazë të certifikatës së sigurisë për qasje në informata të klasifikuara të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me principin “Nevojitet të dijë” nga ana e Drejtorisë lëshohen edhe certifikata të sigurisë për qasje në NATO informata të klasifikuara, certifikata të sigurisë për qasje në informata të klasifikuara të Bashkimit Evropian, ose të organizatave ndërkombëtare të tjera dhe bashkësive në të cilat merr pjesë shteti ynë, me ç’rast kryhen kontrole plotësuese të sigurisë për personin, ku kontrollonhet, nëse personi ka bërë eventualisht aktivitete kundër interesave të shteteve të huaja ose ndaj organizatës ndërkombëtare për të cilat informata të klasifikuara kërkohet lëshimi i certifikatës së sigurisë për qasje në informata të klasifikuara.

Neni 10

Me kërkesë të Drejtorisë, deri te Agjencia për siguri nacionale dhe shërbimeve kompetente të Ministrisë së mbrojtjes, mundet të zbatohen kontrolle plotësuese.

Neni 11

Para lëshimit të certifikatës së sigurisë, Drejtoria ka të drejt të kërkoj të ketë qasje në dokumentet mbi të cilat është zbatuar kontrolli i sigurisë.

Agjencia për siguri nacionale dhe shërbimet kompetente të Ministrisë së mbrojtjes, Drejtorisë i'a mundësojnë qasjen në dokumentet mbi të cilat janë zbatuar kontrollet e sigurisë, brenda 10 ditëve, jo më vonë, nga dita kur e kanë parashtruar kërkesën.

Neni 12

Drejtorja mundet të bëj kontroll të sigurisë, plotësuese, në bashkëpunim me Autoritetin nacional të sigurisë të shtetit të huaj, në të cilin personi që kërkon certifikatë të sigurisë, ende qëndron ose dikur ka qëndruar.

Për personat kërkues të certifikatës së sigurisë të cilët kanë pasur ose ende kanë, dy ose më shumë shtetësi, para lëshimit të certifikatës së sigurisë, Drejtoria mund të kërkoj të dhëna nga organet kompetente të shtetit/shteteve të huaja të cilit/ të cilëve, ka ende ose ka pasur shtetësi personi.

Personat nga pika 2 të këtij neni, për nevojat e kontrollit të sigurisë, dorëzojnë kopje nga letër njoftimi dhe dokumenti për udhëtim të lëshuara në shtete tjera, nëse i posedojnë.

Neni 13

Nëse pas lëshimit të parë, të certifikatës së sigurisë, personi ka punuar pandërprerë në organin ku manipulon me informata të klasifikuara dhe ka nevojë të përhershme të ketë qasje në informata të klasifikuara në pajtim me principin "Nevojitet të dijë" mund të kërkohe vazhdimi i vlefshmërisë së certifikatës së sigurisë për atë person.

Kontrolli i sigurisë për vazhdim të vlefshmërisë së certifikatës së sigurisë e përfshin periudhën kohore, nga kontrolli i fundit deri në momentin e kontrollit të ri.

Vazhdimi i vlefshmërisë së certifikatës së sigurisë bëhet në mënyrën e njëjtë si dhe lëshimi i certifikatës së sigurisë nga neni 2 nga kjo urdhëresë.

Neni 14

Nëse gjatë kohës derisa ka vlefshmëri certifikata e sigurisë për person të caktuar, paraqitet informatë e cila mund të ndikoj në vazhdimësinë e mëtutjeshme të certifikatës së sigurisë, e cila duhet të kontrollohet në mënyrë plotësuese, Drejtoria do të kërkoj nga oficeri për siguri, në organin ku personi i caktuar punon me informata të klasifikuara, t'i merret certifikata e sigurisë, deri në mbarimin e procesit të vërtetimit të rrezikut për personin.

Neni 15

Nëse ndonjë person, për shkak të pranimit së funksionit ose ushtrimit së detyrës zyrtare, urgjente dhe e cila nuk mund të anulohet për më tutje, ka nevojë të ketë certifikatë të sigurisë me shkallë më të lartë, ky lloj i certifikatës së sigurisë mund t'i jepet personit me afat për gjashtë muaj, nëse janë të plotësuara këto kushte:

- personi të posedoj certifikatë të sigurisë me shkallë më të ulët;
- të ketë filluar procesi i lëshimit të certifikatës së sigurisë për shkallën adekuate;
- prej kontrolleve deri atëherë të mos jetë vërtetuar ekzistimi i pengesave të sigurisë.

Neni 16

Për ushtrimin e detyrës zyrtare urgjente dhe e cila nuk mund të anulohet për më tutje, mund të lejohet qasje e njëhershme deri te informatat e klasifikuara për një shkallë më lart nga shkalla e certifikatës së sigurisë që personi e ka, nëse:

- aktiviteti për të cilin qasja është e nevojshme në informata të klasifikuara është i arsyetuar në formë të shkruar nga ana e funksionarit i cili udhëheq me organin ku personi është i punësuar;
- personi veç më ka certifikatë të sigurisë me shkallë më të ulët nga informata që tash duhet të ketë qasje të njëhershme;
- nuk ekzistojnë informata të cilët tregojnë në thyerjen e kritereve, masave, dhe aktiviteteve për mbrojtje të informatave të klasifikuara në sjelljen e deriatëhershme të personit.

Për këto raste oficeri për siguri të informatave të klasifikuara mbanë evidencë e cila përmban edhe informatë për informatat e klasifikuara deri tek të cilat është lejuar qasja.

Neni 17

Personat përdorues të informatave të klasifikuara të cilët kryejnë bartjen e informatave të klasifikuara (postierët) dhe personat të cilët sigurojnë mbrojtjen e informatave të klasifikuara me shkallën "SEKRET" duhet të kenë certifikatë të sigurisë më së paku TEPËR SEKRET.

Për bartjen e informatave të klasifikuara me shkallën TEPËR SEKRET DHE SEKRET SHTETËROR personat shfrytëzues të informatave të klasifikuara që bëjnë bartjen e informatave të klasifikuara (postierët) dhe personat të cilët sigurojnë mbrojtjen e informatave të klasifikuara, duhet të kenë certifikatë të sigurisë me shkallën adekuate të informatave të klasifikuara të cilat i bartin.

Personat përdorues të informatave të klasifikuara që bëjnë bartjen e informatave të klasifikuara (postierët) dhe personat të cilët sigurojnë mbrojtjen e informatave të klasifikuara, duhet të jenë të njoftuar me procedurat e sigurisë për punë me informata të klasifikuara, të marrin instruksione për detyrat e tyre edhe për atë si t'i ruajnë informatat e klasifikuara të cilët u jepen në besim.

Neni 18

Përdoruesit e informatave të klasifikuara, para se t'ju jepet certifikata e sigurisë me shkallë SEKRET dhe më lart ose para se të kenë qasje deri te informatat e klasifikuara me shkallën INTERNE informohen nga ana e oficerit për siguri për masat e sigurisë, procedurat dhe obligimet e tyre gjatë punës dhe ruajtjes së informatave të klasifikuara.

Më së paku një herë në vit, sipas nevojës edhe më shpesh nga ana e oficerit për siguri, përdoruesit e informatave të klasifikuara përsëri informohen për detyrat e tyre të cilat dalin nga Ligji për informata të klasifikuara(*).

Pas informimit të parë dhe njoftimit të përsëritur me detyrat e tyre, përdoruesit e informatave të klasifikuara nënshkruajnë deklaratë me të cilën deklarojnë se plotësisht i kanë kuptuar dispozitat nga Ligji për informata të klasifikuara(*).

Deklaratat nga pika 3 të këtij neni ruhen te oficeri për siguri të informatave të klasifikuara.

Deklaratat për informimet e kryera të përdorueseve për qasje deri tek NATO informatat e klasifikuara, informatat e klasifikuara të BE - s dhe informatat e klasifikuara të tjera ruhen në nën regjistrat gjegjësisht në pikat kontrolluese.

Shfrytëzuesit e informatave të klasifikuara para se të kenë qasje deri te informatat e Republikës së Maqedonisë së Veriut me shenjën PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR informohen nga ana e oficerit për siguri për masat e sigurisë, procedurat dhe obligimet e tyre gjatë menaxhimit dhe ruajtjes së informatave të klasifikuara, për të cilat nënshkruajnë deklaratë me të cilën vërtetojnë se plotësisht i kuptojnë dispozitat nga Ligji i informatave të klasifikuara (*).

Neni 19

Nëse personi fizik ose personi juridik i një shteti të huaj, duhet të ketë qasje në informatat e klasifikuara të Republikës së Maqedonisë së Veriut, organi në të cilin menaxhohet me informata të klasifikuara dhe tek të cilat informata kërkohet qasja, parashton kërkesë deri te Drejtoria për lëshimin e lejes për qasje deri te informatat e klasifikuara të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me kërkesën për lëshimin e lejes për qasje në informata të klasifikuara dorëzohen edhe këto dokumente:

- sqarohet arsyeja pse i duhet personit leja për qasje në informata të klasifikuara, kohëzgjatja e qasjes në informatat e klasifikuara, si dhe të tregohet te cila shkallë e informatave të klasifikuara duhet të ketë qasje personi;
- certifikatë të sigurisë për shkallë adekuate të klasifikimit për person fizik ose juridik për të cilin kërkohet lëshimi i lejes për qasje në informata të klasifikuara, i lëshuar nga organi kompetent në shtetin me të cilin Republika e Maqedonisë së Veriut ka marrëveshje bilaterale ose shtet i huaj i cili është anëtar i NATO - s dhe
- kopje të dokumentit për udhëtim ose dokument tjetër me afat, për identifikim.

Pikat (1) dhe (2) të këtij neni nuk vlejnë për të dhënat të cilat organet shtetërore i këmbajnë me shërbimet e inteligjencës dhe organizatave.

Neni 20

Para se t'i lejohet personit fizik ose juridik nga shteti i huaj, të ketë qasje në informata të klasifikuara të Republikës së Maqedonisë së Veriut, oficeri për siguri të informatave të klasifikuara në organin ku është bërë kërkesën për leje për qasje në informata të klasifikuara, e njofton personin me obligimet e tij që dalin nga Ligji për informata të klasifikuara (*).

Pas njoftimit me obligimet e tij, personat fizik të shtetit të huaj nënshkruajnë deklaratë (me përkthim në anglisht) që plotësisht i kanë kuptuar dispozitat nga Ligji për informata të klasifikuara (*).

Neni 21

Në ditën që hy në fuqi kjo urdhëresë, ndalet të vazhdoj Urdhëresa për siguri të personave shfrytëzues të informatave të klasifikuara („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“)

Neni 22

Kjo urdhëresë hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në („Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“)

Nr. _____
5 korrik 2022

KRYETAR I QEVERISË SË REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË SË VERIUT

Shkup

Dimitar Kovaçevski